**Hapet thirrja për aplikime për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Evora (Konsorciumi AMIGO), në Portugali, në kuadër të programit Erasmus +, për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023.**

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa shkëmbimi për studime / traineeship për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Evora, në Portugali për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023.

https://www.uevora.pt/

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime / traineeship;

**Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Master / Ph.D;

**Kohëzgjatja e bursave:**

- 3 muaj;

**I gjithë procesi i aplikimit kryhet online:**

https://siiue.uevora.pt/auth

**Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin mujor (850 EUR në muaj për studentët);
- Kostot e udhëtimit (360 Euro);

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

**- Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët:**

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti në gjuhën angleze;
- Listë notash (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze;
- Letër rekomandimi në gjuhën angleze (së paku 1);
- Diploma dhe Certifikata kualifikimesh;
- Certifikatë e gjuhës së huaj;
- Për studentët që trajtohen me ndihmë ekonomike duhet edhe vërtetimi përkatës.

**Afati për aplikim: 28 Shkurt 2023.**

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!